

“BACHELOR” NË INFERMIERI E PËRGJITHSHME

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Bachelor nëInfermieri e Përgjithshme
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.42, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimi	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njehësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Infermieri e Përgjithshme është të aftësojë studentët në fushën e infermierisë. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të krijojnë një formim baze në disiplinat infermiere, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë dhe si baze për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në Infermieri apo programet e tjera perkatese integruese.
2. Së dyti, në krijimin e mundësive për futjen e informacionit të ri nga teknologjia infermiere dhe disiplinat aplikative të Mjekësisë, i cili do ta bëjë kuadrin e ardhshëm të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe të perspektivës në arsim, ekonomi dhe biznes.
3. Së treti, do të shërbejë si baze për përgatitjen e kontingjentit i cili do të shërbejë si baza e përgatitjes së kuadrit sa më të përgatitur për studentët e ardhshëm në çdo drejtim infermior, në kushtet e sotme kur ka filluar profilizimi i fushave infermiere.
4. Së katërti, studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.
5. Dhe së pesti, ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e infermierit.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi profesionale që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisinshendetësor në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të Infermieristike Kirurgjikale, Infermieristike Pediatrike, Infermieristike Urgjence etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **LëndëBAZE** (Sociologji, Shkenca Biomedikale 1, Anatomi e njeriut, Fiziologji e njeriut, Anatomi patologjike) **Kredite** (27 kredite)
2. **LëndëKARAKTERIZUESE** (Shkenca Biomedikale 2, Bazat e infermieristikes, Puerikulture & Neonatologji, Semundje te brendshme, Pediatri, Shkenca infermiore 1, Shkenca neuropsikiatrike, Shkenca infermiore 2, Lende kirurgjikale & Infektive, Virologjia&diagnoza laboratorike ne virologji, Shkenca infermiore 3, Obstetike-Gjinekologji & Shendet riprodhues, Shkenca infermiore 4) **Kredite** (93.5 kredite)
3. **LëndëNDERDISIPLINORE/INTEGRUESE** (Biokimi mjekesore & Biofizike mjekesore, Shkencateshendetit, Farmakologji, Lende diagnostikuese dhe terapeutike, Epidemiologji klinike) **Kredite** (24 kredite)
4. **LëndëME ZGJEDHJE** (Dietologji, Faza preanalitike,Psikologji mjekësore,Shkrim projektsh) **Kredite** (3 kredite)
5. **Lëndë të formimit plotësues** (Gjuhë e HuajProfesionale, Informatike&Statistikemjekesore, Praktikeinfermiore 1, Praktikeinfermiore 2) **Kredite** (27 kredite)
6. **DETYRIME PERMBYLLESE** (punim diplome)**Kredite** (5.5 kredite)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e ciklit të parë “Bachelor” në Infermieri e Përgjithshme është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat e studimit në cikle me telartadhe mundësitë e punësimit.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor* në Infermieri e Përgjithshme mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në Master Profesional në Shkencat Infermierore pranë Universitetit të tij apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë , në programet :

1. Master Profesional në Infermieri
2. Master i Shkencave në Infermieri

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë në fushën e infermierisë. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Infermierore në pavionet spitalore ku do të zgjidhin problemet perkatëse duke iu përgjigjur më së miri kërkesave të tyre dhe zhvillimeve të sotme në fushën e duhur.
2. Infermiere në Poliklinikat e Specialiteteve.
3. Infermiere në Qendrat Shëndetësore dhe ambulancat e tyre.
4. Specialist infermierore në Drejtoritë e Shëndetit Publik. Ky front i punësimit realizon edhe objektivin strategjik të MASR dhe MSHMS sipas të cilit profili infermioror zë vend më të rëndësishëm në punësimin aktual.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Bachelor” në Infermieri e Përgjithshme fitojnë njohuri në lëndet baze mjekësore dhe në disiplinat mjekësore të specialiteteve.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	GJUHE E HUAJ PROFESIONALE	4	100	I
2.	SOCIOLOGJI	4.5	112.5	I
3.	INFORMATIKE & STATISTIKE MJEKESORE	3	75	I
4.	SHKENCA BIOMEDIKALE 1	7	175	I
5.	SHKENCA BIOMEDIKALE 2	5	125	I
6.	ANATOMI E NJERIUT	6	150	I+II
7.	BAZAT E INFERMIERISTIKES	11	275	I+II
8.	FIZIOLOGJI E NJERIUT	4.5	112.5	II
9.	BIOKIMI MJEKESORE & BIOFIZIKE MJEKESORE	5	125	II
10.	PUERIKULTURE & NEONATOLOGJI	4.5	112.5	II
11.	SHKENCA TE SHENDETIT	5	125	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	I+II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	ANATOMI PATOLOGJIKE	5	125	I
2.	SEMUNDJE TE BRENDSHME	7	175	I
3.	PEDIATRI	5	125	I
4.	SHKENCA INFERMIERORE 1	10	250	I
5.	PRAKTIKE INFERMIERORE 1	10	250	I+II
6.	SHKENCA NEUROPSIKIATRIKE	5	125	II
7.	SHKENCA INFERMIERORE 2	10	250	II
8.	FARMAKOLOGJI	5	125	II
Lëndë me zgjedhje				
9.	A. DIETOLOGJI	3	75	II
	B. FAZA PREANALITIKE	3	75	II
	C. PSIKOLOGJI MJEKESORE	3	75	II
	D. SHKRIM PROJEKTESH	3	75	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	I+II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	LENDE KIRURGJIKALE & INFEKTIVE	7	175	I
2.	VIROLOGJIA DHE DIAGNOZA LABORATORIKE NE VIROLOGJI	6	150	I
3.	LENDE DIAGNOSTIKUESE DHE TERAPEUTIKE	6	150	I
4.	EPIDEMIOGJI KLINIKE	3	75	I
5.	PRAKTIKE INFERMIERORE 2	10	250	I+II
6.	SHKENCA INFERMIERORE 3	8	200	II
7.	OBSTETRIKE , GJINEKOLOGJI & SHENDET RIPRODHUES	6.5	162.5	II
8.	SHKENCA INFERMIERORE 4	8	200	II
9.	Provimi formimi / Punimi diplome	5.5	137.5	II
Gjithësej viti i tretë		60 ECTS	1500	I+II
Total : viti I + viti II + viti III		180 ECTS	4500	-